Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0487

Paneli Shqyrtues, i caktuar në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Isa Hasani, duke vendosur sipas ankesës së OE "Office 1 Kosova" SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me buqeta lulesh natyrale,shtiza për flamuj dhe flamuj të ndryshëm për nevojat e Komunës së Prizrenit" me numër të prokurimit 622-26-2912-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna Prizren, më 24/08/2026, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet pjesërisht e bazuar ankesa e OE "Office 1 Kosova" SH.P.K. me nr. 2026/0487 , e datës 10/07/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me buqeta lulesh natyrale,shtiza për flamuj dhe flamuj të ndryshëm për nevojat e Komunës së Prizrenit", me numër të prokurimit 622-26-2912-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues/ Komuna Prizren.

2.Mbetet në fuqi B58 "Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues" - Komuna Prizren për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me buqeta lulesh natyrale,shtiza për flamuj dhe flamuj të ndryshëm për nevojat e Komunës së Prizrenit", me numër të prokurimit; 622-26-2912-1-2-1.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

4. Bazuar në nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues OE "Office 1 Kosova" SH.P.K, i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për tërheqje të tarifës për sigurim të ankesës, në të kundërtën bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 29.04.2026. KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT.,duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit Furnizim me buqeta lulesh natyrale,shtiza per flamuj dhe flamuj te ndryshem per nevojat e Komunes se Prizrenit" me nr. të prokurimit: "622-26-2912-1-2-1"

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 105,000.00 €

Me 25.06.2026 KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "Sfinga SH.P.K."

Me 30.06.2026, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 02.07.2026 AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 10.07.2026, OE**"Office 1 Kosova SH.P.K."** ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2026/0487, kundër njoftimit për dhënje të kontratës.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "OFFICE 1 KOSOVA SH.P.Kjanë parashtruar si në vijim:

Kjo ankesë paraqitet kundër:

Vendimit mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim;

Vendimit për tenderuesin e suksesshëm Sfinga Sh.P.K.

Autoriteti Kontraktues ka shkelur këto Nene të LPP-së:

Neni 1 - Qëllimi i Ligjit për Prokurimin Publik

Autoriteti Kontraktues nuk ka zhvilluar procedurën në mënyrë që të sigurojë përdorimin e drejtë, transparent dhe të barabartë të procedurës së prokurimit, pasi ka vendosur një kërkesë në dokumentacionin e tenderit për dorëzimin e mostrave dhe më pas e ka injoruar plotësisht gjatë vlerësimit.

Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Vendosja e një kërkese për dorëzimin e mostrave, e cila më pas nuk është marrë fare në konsideratë, ka krijuar kosto të panevojshme për operatorët ekonomikë dhe nuk i ka shërbyer zhvillimit efikas të procedurës.

Neni 7 - Barazia në Trajtim, Mosdiskriminimi dhe Transparenca

Ne kemi respektuar kërkesën për dorëzimin e mostrave, ndërsa operatorët që nuk e kanë përmbushur këtë kërkesë janë trajtuar njësoj. Për më tepër, Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë arsyetim se si është zbatuar kjo kërkesë gjatë procesit të vlerësimit.

Neni 28 - Specifikimet Teknike

Autoriteti Kontraktues ka përfshirë në dokumentacion një kërkesë teknike për dorëzimin e mostrave, por nuk e ka zbatuar atë gjatë vlerësimit të ofertave, duke krijuar paqartësi mbi përmbajtjen dhe efektin juridik të dokumentacionit të tenderit.

Neni 56 - Përgjegjshmëria e Tenderëve

Autoriteti Kontraktues nuk ka vlerësuar në mënyrë të njëjtë përmbushjen e kërkesave të dokumentacionit nga të gjithë operatorët ekonomikë dhe nuk ka analizuar përmbushjen e kërkesës për dorëzimin e mostrave.

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Procesi i vlerësimit nuk është zhvilluar në përputhje me dokumentacionin e tenderit, pasi nuk ekziston asnjë analizë, procesverbal apo arsyetim lidhur me dorëzimin dhe vlerësimin e mostrave, megjithëse kjo kërkesë ishte e përfshirë në paramasë.

Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës

Autoriteti Kontraktues nuk ka zbatuar në mënyrë të plotë dhe konsistente kriteret dhe kërkesat që vetë i ka publikuar në dokumentacionin e tenderit para dhënies së kontratës.

Vendimi i Autoritetit Kontraktues shkon në kontradiktë të drejtpërdrejtë me dokumentacionin e tenderit.

Në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim Autoriteti Kontraktues deklaron se:

"Në asnjë dispozitë të Njoftimit për Kontratë, në Dosjen e Tenderit dhe në Specifikimin Teknik nuk është paraparë obligimi për dorëzimin e mostrave."

Ky konstatim është faktikisht i pasaktë.

Në Paramasë, e cila është pjesë integrale e dokumentacionit të tenderit, ekziston qartë kërkesa:

"Para hapjes së ofertave të sillen mostrat e flamujve."

Prandaj Autoriteti Kontraktues nuk mund të pretendojë se një kërkesë e publikuar nuk ekziston.

Në momentin kur Autoriteti Kontraktues vendos një kërkesë në dokumentacionin e tenderit, ajo kërkesë bëhet detyruese për të gjithë operatorët ekonomikë.

Ne kemi vepruar në mirëbesim dhe kemi përmbushur këtë obligim.

Operatorët e tjerë nuk e kanë përmbushur.

As operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës (Sfinga Sh.P.K.) nuk ka dorëzuar mostrat e kërkuara, ndonëse të gjithë kanë nënshkruar dhe vulosur Paramasën ku është përcaktuar qartë obligimi: "Para hapjes së ofertave të sillen mostrat e flamujve".

Përkundër këtij fakti, Autoriteti Kontraktues ka rekomanduar për dhënie të kontratës operatorin ekonomik që nuk ka përmbushur këtë kërkesë, ndërsa kërkesën e dokumentacionit të tenderit e ka injoruar plotësisht gjatë procesit të vlerësimit.

Një veprim i tillë cenon: transparencën; trajtimin e barabartë; proporcionalitetin; sigurinë juridike.

Operatorët ekonomikë nuk mund të detyrohen të përmbushin kërkesa të cilat më pas Autoriteti Kontraktues vendos ti injorojë.

Autoriteti Kontraktues nuk ka zbatuar dokumentacionin e tenderit

Autoriteti Kontraktues nuk ka paraqitur:

procesverbal të pranimit të mostrave;

evidencë se cilët operatorë kanë dorëzuar mostra;

evidencë se cilët operatorë nuk kanë dorëzuar mostra;

raport të vlerësimit të mostrave;

arsyetim pse kjo kërkesë nuk është marrë në konsideratë.

Nëse kërkesa për mostra nuk kishte efekt juridik, ajo nuk duhej të vendosej fare në dokumentacionin e tenderit.

Nëse kishte efekt juridik, ajo duhej të zbatohej në mënyrë të barabartë ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë.

Autoriteti Kontraktues nuk mund të zgjedhë pas hapjes së ofertave se cilat kërkesa të dokumentacionit do ti zbatojë dhe cilat jo.

Autoriteti Kontraktues ka shkelur parimin e pritjeve legjitime

Ne si Operator Ekonomik kemi organizuar përgatitjen, prodhimin dhe dorëzimin e mostrave duke bartur kosto shtesë vetëm sepse Autoriteti Kontraktues e kishte kërkuar këtë.

Më pas Autoriteti Kontraktues deklaron se kjo kërkesë nuk ka ekzistuar.

Një veprim i tillë cenon rëndë besimin e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik.

Autoriteti Kontraktues ka bërë verifikimin e mostrave të flamujve pas hapjes së ofertave tek OE e propozuar për kontratë, në vendin ku OE e ushtron veprimtarinë, edhe pse në paramasë theksohet qartë që verifikimi në vendin ku OE e ushtron veprimtarinë do të bëhet vetëm për Buqetat me lule, ndërsa mostrat e flamujve duhet të sillen para hapjes së ofertave.

Edhe gjatë verifikimit të mostrave të flamujve (të cilat duhet të dorëzoheshin para hapjes së ofertave), AK bën verifikim të mangët (siç shihet në foton e bashkangjitur), pasi ka marrë vetëm 3 mostra të flamujve, ndërsa duhet të dorëzoheshin 10 mostra për 10 pozicione të flamujve.

Autoriteti Kontraktues ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit sipas procedurës së hapur me kriter Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Ne si Operator Ekonomik kemi dorëzuar ofertë të përgjegjshme dhe gjatë përgatitjes së ofertës kemi respektuar të gjitha kërkesat e dokumentacionit të tenderit.

Në dokumentin "Paramasat për flamuj dhe lule natyrale 2026-2028 pa çmime", i cili është i bashkangjitur dhe mund edhe të shkarkohet në E-Prokurim dhe i cili është pjesë e dokumentacionit të tenderit, Autoriteti Kontraktues ka vendosur shprehimisht kërkesën:

"Vërejtje: Para hapjes së ofertave të sillen mostrat e flamujve."

Duke u bazuar në këtë kërkesë, ne kemi dorëzuar mostrat para hapjes së ofertave.

Nga informacionet dhe dokumentacioni i procedurës rezulton se operatori ekonomik i shpallur fitues nuk ka dorëzuar mostrat e kërkuara, ndërsa Autoriteti Kontraktues nuk ka bërë asnjë verifikim, nuk ka përpiluar asnjë procesverbal të vlerësimit të mostrave dhe nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me këtë kërkesë.

Kërkesën për sjelljen e mostrave të flamujve para hapjes së ofertave e gjeni edhe në ofertën (paramasën e çmimeve) të operatorit fitues të nënshkruar dhe vulosur, të cilën e kemi bashkangjitur.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Operatori Ekonomik Office 1 Kosova sh.p.k. pretendon se operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës është dashur të eliminohej për shkak të mosdorëzimit të mostrave të produkteve

Pas analizimit të plotë të kërkesës për rishqyrtim, të Njoftimit për Kontratë, Dosjes së Tenderit dhe dokumentacionit të procedurës së prokurimit, Autoriteti Kontraktues konstaton se ky pretendim është plotësisht i pabazuar në aspektin faktik dhe juridik.

Autoriteti Kontraktues vëren se në asnjë dispozitë të Njoftimit për Kontratë, në Dosjen e Tenderit, në Specifikimin Teknik nuk është paraparë obligimi për dorëzimin e mostrave nga operatorët ekonomikë. Rrjedhimisht, dorëzimi i mostrave nuk ka qenë kusht i pjesëmarrjes, kriter i kualifikimit, kriter për përgjegjshmërinë e ofertës apo element i vlerësimit të ofertave.

Në procedurat e prokurimit publik vlejnë ekskluzivisht kushtet dhe kriteret e publikuara paraprakisht. Autoriteti Kontraktues nuk mund të vlerësojë oferta mbi bazën e kërkesave që nuk janë bërë pjesë e dokumentacionit të tenderit, ashtu sikurse operatorët ekonomikë nuk mund të kërkojnë eliminimin e konkurrentëve mbi baza që nuk ekzistojnë në dokumentet e tenderit. Çdo

veprim i tillë do të ishte në kundërshtim me parimet e transparencës, trajtimit të barabartë, proporcionalitetit dhe sigurisë juridike.

Neni 37 i Rregullores për Prokurimin Publik parasheh se, kur Autoriteti Kontraktues e konsideron të nevojshme paraqitjen e mostrave, kjo kërkesë duhet të përcaktohet qartë në dokumentet e tenderit, duke specifikuar llojin e mostrave, afatin, mënyrën dhe kushtet e dorëzimit. Qëllimi i kësaj dispozite është që çdo operator ekonomik të njihet paraprakisht me të gjitha obligimet që ndikojnë në përgatitjen e ofertës dhe në vendimin për pjesëmarrje në procedurë.

Në rastin konkret, mungesa e një kërkese të tillë në dokumentet e tenderit nënkupton se asnjë operator ekonomik nuk ka qenë i detyruar të dorëzojë mostra. Për këtë arsye, mosdorëzimi i mostrave nuk mund të prodhojë pasoja juridike dhe nuk mund të shërbejë si bazë për shpalljen e një oferte të papërgjegjshme ose për eliminimin e një operatori ekonomik.

Pretendimi i operatorit ekonomik bazohet mbi një obligim që nuk ekziston në dokumentet e tenderit dhe, si i tillë, nuk mbështetet në Ligjin për Prokurimin Publik, në Rregulloren për Prokurimin Publik dhe as në dokumentacionin e procedurës. Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues vlerëson se procesi i vlerësimit është zhvilluar në përputhje me kërkesat e publikuara dhe se nuk ekziston asnjë shkelje procedurale apo materiale që do të justifikonte anulimin ose rivlerësimin e procedurës.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me date 10.07.2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2026/0487, ndërsa me datë 24.07.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0487, me rekomandimet si në vijim:
Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues aprovohet pjesërisht si e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK është pajtuar rreth rekomandimit te raportit të ekspertit shqyrtues, po ashtu as OE nuk është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE“OFFICE 1 KOSOVA SH.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0487 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim hyrës: OE ankues ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së si palë e pakënaqur me vendimin e AK-së në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit duke ngritur disa pretendime ankimore. Pretendimet e ngritura janë shqyrtuar nga eksperti shqyrtues dhe i njëjti sipas mendimit të tij ka dhënë përgjigje si më poshtë.

Pretendim

"AK ka bërë shkelje të disa neneve të Ligjit për Prokurimin Publik duke mos i përfillur kriteret të cilat vet ajo i ka vendosur në dokumentacionin e tenderit, ku ka kërkuar dorëzimin e mostrave dhe më pas e ka injoruar plotësisht këtë këresë gjatë vlerësimit. Pra, AK gjatë procesit të vlerësimit ka trajtuar njësoj operatorët të cilët kanë dorëzuar mostra dhe atë të cilët nuk e kanë përmbushur kërkesën për dorëzimin e mostrave. AK ka arsyetuar që në asnjë dispozitë të dokumenteve të tenderit nuk ka paraparë obligim për dorëzimin e mostrave e që është i pasaktë, sepse kjo gjë është kërkuar në paramasë që është pjesë integrale e dokumentacionit të tenderit. AK nuk mund të zgjedhë pas hapjes së ofertave se cilat kërkesa të dokumentacionit do t'i zbatoj dhe cilat jo."

Përgjigje

Eksperti shqyrtues në lidhje me këtë pretendim të ngritur nga operatori ankues sqaron që sipas dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë në pjesën e kërkesave të përfshira nuk dëshmohet se është kërkuar që operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të dorëzojnë mostrat para hapjes së ofertave.

Në dosjen e tenderit, mostrat janë përmendur vetëm në Aneksi1- Specifikimet teknike të detyrueshme, si vërejtje nga ana e autoritetit sipas të cilit sqarohet se komisioni ka të drejtën e kontrollit dhe verifikimit të mostrave të ofruara në këtë projekt në vendin ku ushtrohet veprimtaria nga ana e operatorit ekonomik duke pasqyruar që mostrat për këtë aktivitet do të kontrollohen dhe verifikohen në vendin e veprimtarisë ku operon operatori. Citim: "VËREJTJE: Komisioni për vlerësim të ofertave mban të drejtën e kontrollit dhe të verifikimit të mostrave të ofruara në këtë projekt tek secili OE në vendin ku ushtron veprimtarinë, dhe nëse komisioni vlerësues i AK konstaton se mostrat e ofruara nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të ngritura në DT dhe NJK, OE shpallet i papërgjegjshëm."

Tutje, sqarojmë që kërkesa për mostrat shihet e përfshirë vetëm në paramasën e publikuar nga autoriteti tek pjesa e Flamujve, ku është përfshirë një vërejtje në fund të dokumentit duke kërkuar që mostrat e flamujve duhet të sillen para hapjes së ofertave.

Në raportin e vlerësimit të tenderëve është bashkëngjitur edhe një e-mail nga komisioni i vlerësimit sipas të cilëve sqarohet se komisioni ka dal në teren për verifikimin e mostrave tek operatori i rekomanduar për kontratë dhe si përfundim kanë konstatuar se plotësohen kushtet.

Në lidhje me këtë situatë eksperti shqyrtues sipas mendimit të tij konsideron që të gjitha kërkesat relevante duhet të përfshihen në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit. Në dosjen e tenderit, përfshirë edhe Aneksi 1 në asnjë pikë nuk është kërkuar nga operatorët që të dorëzojnë mostrat para hapjes së ofertave, një kërkesë e tillë shihet si vërejtje vetëm tek paramasa për flamuj. Sipas mendimit tonë përderisa një kërkesë decidive për dorëzimin e mostrave nuk ka qenë e cekur në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit sipas nenit 56, pika 3 e Ligjit për Prokurimin Publik tenderuesi nuk do të diskualifikohet për kërkesa të cilat nuk janë të cekura

paraprakisht në DT dhe NJK. Vlerësojmë që AK nuk ka bërë favorizim të ndonjë operatori të caktuar ekonomik, sepse sipas tyre vlerësimi i të gjithë operatorëve është bërë në bazë të kërkesave të cekura në dosje dhe jo nga mostrat përkatëse. Ashtu siç është cekur në Aneksi 1, kontrolli dhe verifikimi i mostrave është bërë nga komisoni vlerësues për operatorin e rekomanduar vetëm para se ky operator të rekomandohet për kontratë me vendim të autoritetit.

Sipas mendimit të ekspertit shqyrtues, trajtim jo të barabartë të operatorëve ekonomik do të kishte në rastin kur vlerësimi kryesor i ofertave do të bëhej vetëm përmes mostrave përkatëse dhe se ky vlerësim do të konsiderohej i pranueshëm njësoj si për ata të cilët kanë dorëzuar mostrat me ofertë si për ata operatorë të cilët nuk kanë dorëzuar mostrat dhe që AK ka vlerësuar mostrat e tyre duke i verifikuar direkt në terren. Pra, përderisa vlerësimi i ofertave të të gjithë operatorëve është bërë në bazë të kërkesave të FDT-së dhe verifikimi i tyre është bërë vetëm para rekomandimit të operatorit i cili ka plotësuar më mirë kërkesat, gjithmonë sipas mendimit tonë, nuk konsiderojmë që përbënë diskriminim dhe trajtim jo të barabartë të operatorëve ekonomik pjesëmarrës.

Gjithsesi, AK është dashur të tregohej e kujdesshme në përpilimin e kërkesave të cilat i ka përfshirë në dokumentet e tenderit në mënyrë që të mos krijoj paqartësi tek operatorët eknomik dhe të mos vendosen kritere të cilat bien ndesh me njëra tjetrën. Megjithatë, sipas mendimit të ekspertit konsiderojmë që operatorët ekonomik nuk mund të diskualifikohen nga aktiviteti i prokurimit për arsye të gabimeve të lëshuara nga ana e vet autoritetit kontraktues.

Nga sqarimet e bëra më lartë konsiderojmë që pretendimi i ngritur nga ana e operatorit ekonomik është pjesërisht i bazuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në ketë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj

fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli vren se Autoriteti Kontraktues gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës publike furnizim me pjesë. Vlera e parashikuar 105,000.00€. Kriteret e Dhënies së kontratës Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët.

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, sqarojmë se operatori ekonomik ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 7,28,56,59,60, të LPP-së, si dhe nenin 37, të Rregullores për Prokurim Publik nr.001/2022. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër vendimit te AK me te cilin ka rekomanduar per dhenje te kontrates OE,Sfinga SH.P.K., ndersa ankuesin e ka eleminuar per mosplotsim te kritereve te DT. Pretendimet e ngritura ankimore nga ana e operatorit ekonomik ankues janë shqyrtuar nga eksperti shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe kërkesave te dosjes se tenderit, duke i vlersuar pretendimit ankimore jane pjeserisht të bazuara dhe ka rekomanduar te mbetet ne fuqi vendimi i autoritetit kontraktues.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur meçështjen në rastin konkret, parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor. Në ketë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse në ketë rast.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore konstaton se ankesa eshte pjeserisht e bazuar dhe mbet ne fuqivendimi i AK-se.

Paneli vren se OE ankues lidhur me pretendimin per dorzimin e mostrave konstaton se që sipas dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë në pjesën e kërkesave të përfshira nuk dëshmohet se është kërkuar që operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të dorëzojnë mostrat para hapjes së ofertave. Në dosjen e tenderit, mostrat janë përmendur vetëm në Aneksi1- Specifikimet teknike të detyrueshme, si vërejtje nga ana e autoritetit sipas të cilit sqarohet se komisioni ka të drejtën e kontrollit dhe verifikimit të mostrave të ofruara në këtë projekt në vendin ku ushtrohet veprimtaria nga ana e operatorit ekonomik duke pasqyruar që mostrat për këtë aktivitet do të kontrollohen dhe verifikohen në vendin e veprimtarisë ku operon operatori. Citim: “VËREJTJE: Komisioni për vlerësim të ofertave mban të drejtën e kontrollit dhe të verifikimit të mostrave të ofruara në këtë projekt tek secili OE në vendin ku ushtron veprimtarinë, dhe nëse komisioni vlerësues i AK konstaton se mostrat e ofruara nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të ngritura në DT dhe NJK, OE shpallet i papërgjegjshëm.” . Të gjitha kërkesat relevante duhet të përfshihen në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit. Në dosjen e tenderit, përfshirë edhe Aneksi 1 në asnjë pikë nuk është kërkuar nga operatorët që të dorëzojnë mostrat para hapjes së ofertave, një kërkesë e tillë shihet si vërejtje vetëm tek paramasa për flamuj. Sipas mendimit tonë përderisa një kërkesë decidive për dorëzimin e mostrave nuk ka qenë e cekur në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit sipas nenit 56, pika 3 e Ligjit për Prokurimin Publik tenderuesi nuk do të diskualifikohet për kërkesa të cilat nuk janë të cekura paraprakisht në DT dhe NJK. Vlerësojmë që AK nuk ka bërë favorizim të ndonjë operatori të caktuar ekonomik, sepse sipas tyre vlerësimi i të gjithë operatorëve është bërë në bazë të kërkesave të cekura në dosje dhe jo

nga mostrat përkatëse. Ashtu siç është cekur në Aneksi 1, kontrolli dhe verifikimi i mostrave është bërë nga komisoni vlerësues për operatorin e rekomanduar vetëm para se ky operator të rekomandohet për kontratë me vendim të autoritetit.

Paneli kostaton se trajtim jo të barabartë të operatorëve ekonomik do të kishte në rastin kur vlerësimi kryesor i ofertave do të bëhej vetëm përmes mostrave përkatëse dhe se ky vlerësim do të konsiderohej i pranueshëm njësoj si për ata të cilët kanë dorëzuar mostrat me ofertë si për ata operatorë të cilët nuk kanë dorëzuar mostrat dhe që AK ka vlerësuar mostrat e tyre duke i verifikuar direkt në terren. Pra, përderisa vlerësimi i ofertave të të gjithë operatorëve është bërë në bazë të kërkesave të FDT-së dhe verifikimi i tyre është bërë vetëm para rekomandimit të operatorit i cili ka plotësuar më mirë kërkesat, gjithmonë sipas mendimit tonë, nuk konsiderojmë që përbënë diskriminim dhe trajtim jo të barabartë të operatorëve ekonomik pjesëmarrës.

Rrjedhimisht Paneli shqyrtues e mbështet Raportin me rekomandim te ekspertit shqyrtues nr.0487/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me buqeta lulesh natyrale,shtiza për flamuj dhe flamuj të ndryshëm për nevojat e Komunës së Prizrenit", me numër të prokurimit 622-26-2912-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues/ Komuna Prizren dhe ka vendosur që ankesa të aprovohet si pjesërisht e bazuar e OE "Office 1 Kosova" SH.P.K. dhe Mbetet në fuqi B58 "Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues"dt. 25.06.2026, për rekomandimin e ofertës së operatorit ekonomik për kontrate me qmim me te lire se sa ankuesi, lidhur me aktivitetin e prokurimit te larteshenuar se autoriteti kontraktues ka zbatuar dispozitat ligjore të LPP-se.

Paneli sqaron se po ashtu kërkesat e autoritetit kontraktues janë të paracaktuara në dosjen e tenderit dhe si të tilla është përgjegjësi publike për të gjithë ofertuesit eventual, duhen të udhëhiqen nga parimi i kujdesit në plotsimin e kushteve të formale në kohë dhe brenda afatit të përcaktuar, kurse kthimi i një aktiviteti të prokurimit në vijim të provave jo kontestuese nuk ofron bazë ligjore për ri-vlerësimin eventual të tij dhe nuk është në harmoni me nenin 1 dhe nenit 7 të LPP. Në fakt synimi i aktiviteteve të prokurimit i referohet dhe nenit 104 paragrafi 4 i LPP-së, Në ndërmarrjen e masave të përcaktuara në këtë Pjesë IX, OSHP duhet (i) të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, (ii) të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe (iii) të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj" lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës"

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit si të pjesërishëm të ankeses të OE "Office 1 Kosova" SH.P.K.,vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me padi mund t'i drejtohet Gjykatës Administrative në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm për anulim të vendimit në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**
- OE - **OFFICE 1 KOSOVA SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: